



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të nenit 12, 14 dhe 17 shkronja (h) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28 datës 4 Qershor 2008, nenit 9 shkronja (h), 17 dhe 20 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e vet të mbajtur me 30.04.2026, pas shqyrtimit të propozim Vendimit mori këtë:

VENDIM
PËR CAKTIMIN E LOKACIONIT PËR SHKOLLËN FILLORE E MESME E ULËT
"VËLLËZRIT FRASHËRI" NË LIPJAN

Neni 1

Me këtë Vendim caktohet lokacioni për Shkollën Fillore e Mesme e Ulët "Vëllëzrit Frashëri" në Lipjan me sipërfaqe prej 19057m² nga njësia kadastrale P-71409044-00846-8 në vendin e quajtur "Bezimeni" e evidentuar në certifikatën e pronësisë Nr.1152/2026 në ZK-Lipjan, nga P.SH.Shkolla Bujqësore në Lipjan.

Neni 2

Caktimi i sipërfaqes ashtu siç u cek në nenin 1 të këtij Vendimi, bëhet me qëllim të ristrukturimit të shkollave të qytetit të Lipjanit dhe bartjes së pronësisë të njësive kadastrale të lartëcekur nga P.SH.Shkolla Bujqësore në emër të SHFMU "Vëllëzrit Frashëri" në Lipjan, si pjesë e interesit publik.

Neni 3

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset: Zyra e Kryetarit-Sektori pronëso- juridik, Drejtoria Komunale e Arsimit dhe Drejtorati për Gjeodezi dhe Kadastër.

Neni 4

Ky vendim hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në ueb-faqen elektronike të Komunës.

Nr. 15-353/01-20083
Lipjan, më 30.04.2026

KUVENDI I KOMUNËS LIPJAN



Kryesuesi i Kuvendit
Daut Azemi

Page 1 of 1